

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EKSK” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

Z. Enon Karapici, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 09/01/1977, lindur në Durres, banues në Durres; Lagjja nr. 1; Rruga. Kleosteni; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. leternjoftimi 035887669 dhe nr. personal H70109124W.

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 08/11/2023 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “EKSK”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “EKSK”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “EKSK”, do të ketë selinë e saj qëndrore në: DURRES Lagjja 3, Rruga Grigor Durrsaku, EGT Center, Kati i tretë, Zona Kadastrale 8514, Nr.Pasurie 3/319.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Pergatitjen e planeve te biznesit per nevojat e drejtuesve dhe per palet e treta, rivleresim aktivitetesh, keshillime biznesi mbi mundesite e zhvillimit, keshillime per fillim aktiviteti tregtar etj. Sherbime te tjera te lidhura me shoqerite tregtare, si: ndarje, bashkim,perthithje, administrim, likujdim, falimentim; rritje

dhe zvogelim kapitali; hetime te posacme, perfaqesim ne ceshtje gjyqesore qe" kerkojne nje ekspertize kontabile ose fiskale, tregtare, ekonomike etj. Konsulenca ekonomike, financiare dhe fiskale. Konsulenca fiskale, per njohjen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal. Perfaqesimi i njesive ekonomike si per qellime tatimore, gjyqesore apo kundrejt paleve te treta. Organizimi i kurseve te trajnimit profesional ne fushen e finances e te administrimit financiar. Realizimin e kontratave, marreveshjeve, ortakerive shoqerive te perbashketa apo formave te tjera te lejuara nga legjilacioni shqiptar, me persona fizike dhe juridike, shqiptar ose te huaj, per te realizuar operacione tregtare dhe veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe me interes per shoqerine si dhe per cdo lloj aktiviteti qe do ti sherbeje realizimit te objektit. Hartimi, trajnimi dhe aplikime ne lidhje me projekte nderkombetare.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "EKSK" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "EKSK" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

- 8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "EKSK" SHPK është 100.000 (njeqindmije) Leke, e ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm.
- 8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Enon Karapici është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e shoqërisë

- 9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. Enon Karapici.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Enon Karapici

DÛRRES 08/11/2023